



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 31.01.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **27.01.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi fizik i objektit të MSH-së dhe depos së barnave”** me Nr. të Prok: **206-22-11504-2-1-1** nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të Scorpion të dt. 27.01.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objektit të MSH-së dhe depos së barnave”, me Nr. Brendshëm 206-22-11504-2-1-1, kundër Njoftimit të Vendimit të Autoritetit Kontraktues (Njoftim për dhënie të Kontratës, të datës 25.01.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Vërtetohet vendimi i AK për dhënien e kontratës i publikuar me datë: 25.01.2023;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Scorpion** me datë 27.01.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objektit të MSH-së dhe depos së barnave”, me Nr. të prokurimit: 206-22-11504-2-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 31.01.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që pretendohet se janë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion:**

- Neni 1 - Qëllimi

- Neni 7 - Barazia ne trajtim / Jo-Diskriminimi
- Neni 59 - Ekzamini, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve
- Neni 60 - Kriteret per Dhenie te Kontrates
- Neni 61 - Tenderet Jo-Normalisht të ulët

#### 1. Pretendimi ankimor 1

Me këtë vendim nga ana e juaj , konsiderojme se ju si AK keni rënë ndesh me **Nenin 1 të LPP-së** sepse duke iu referuar këtij neni, qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla, ashtu sic citohet edhe në ligj.

#### Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin 1

**Neni 1 (Qëllimi)** - sipas këtij neni qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. AK e ka respektuar këtë nen duke shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulet sepse OE i shpërblyer me kontratë ka përmbushur te gjitha kërkesat e parashtruara ne DT. Ne te njëjtën kohe AK thekson se nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite. Prandaj pretendimi ankimor eshte i PA BAZUAR

#### 2. Pretendimi ankimor 2

Ju si AK nuk keni vepruar sipas **Nenit 7** të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili parasheh trajtimin e barabartë për të gjithë operatorët ekonomik dhe në të njëjtën kohë ky ligj udhëzon AK që të mos ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Pra sipas Kërkesës Nr 4, Pozicioni 9.1 & 9.2. "Operatori ekonomik me ofertë duhet te prezantojë një analizë financiare për pagën bazë të pasqyruar më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet te përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimi e OE, TVSH-ne, Totali i ofertës".

Pra, sic e shihni ne tabelën totale për 36 muaj, fitimi i Kompanisë SCORPION sh.p.k është 8.13€ dhe diferenca e cmimit total me Kompaninë e shpallur fitues është 2,390.17€ (minus).

Pra, nese heqim 8.13€ të fitimit të Kompanisë SCORPION Sh.p.k, i bie që Kompania e shpallur fitues nga AK është – 2,382.04€ nën shpenzimet e parapara nga AK dhe si pasojë e kësaj vlere nën shpenzime është shume e madhe dhe AK duhet të shpallë OE të shpallur fitues si OE të papërgjegjshëm dhe jo të shpërblejë me kontratë.

#### Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin 2

**Neni 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi)** - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke trajtuar te gjithë OE ne mënyre te barabarte dhe ne te njëjtën kohe thekson se OE i shpallur fitues ka dorëzuar Analizën financiare se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet te përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimi e OE, TVSH-ne. Totali i ofertës eshte dhene ne Listen e Cmimeve. Prandaj pretendimi ankimor eshte i PA BAZUAR.



### 3. Pretendimi ankimor 3

Sic shihet nga llogaritjet e dy cmimeve të OE, Cmimi i OE 149.380,07€, të shpallur fitues nga AK, nuk mund të mbulojë shpenzimet për punëtorë sipas kërkesave të AK-së dhe dispozitave ligjore të Ligjit të Punës. Andaj, në vlerësojmë që ky çmim i ofertuar është çmim jo-normalisht i ulët, dhe **Neni 61 i LPP-së** thekson se: nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, AK do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë sqarim se si ka ardhur në përfundim të cmimit.

Pra theksojmë se cdo cmim i cili është nën 151,770.24€ llogaritet cmim jo-normalisht i ulët.

Pra, tani do shfaqim Analizën Financiare (në formë screenshot) të OE të shpallur fitues nga AK.

Pra, sic e shihni në llogaritjet në Analizën Financiare të OE të shpallur fitues janë të radhitur gabimisht me apo pa qëllim dhe e bërë jashtë kërkesave të AK-së sepse AK ka kërkuar se "Operatori ekonomik me ofertë duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë të pasqyruar më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimi e OE, TVSH-ne, Totali i ofertës".

Pra për të kamufluar cmimin e saktë total, radhitja e llogaritjeve është e gabuar dhe jo sipas kërkesave të AK, sic e shihni më lartë në analizën financiare të OE të shpallur fitues, llogaritja është bërë kështu duke filluar nga paga Net, kontributet pensionale, Oret e Nates, Oret e Festave, Fitimi, Tvsh-ja dhe Kostoja totale për një punëtorë dhe nuk është shfaqur as cmimi total për 36 muaj sic është kërkuar nga AK.

Tek pozicionet 6,7,8 janë shfaqur vetëm vlerat numerike për orët shtesë të natës, festave dhe pushimeve vjetore, pa dhënë një shpjegim se si ka ardhur deri tek vlera totale dhe poashtu janë vlera të pa tatura në Kontributet Pensionale, prandaj edhe vlerat numerike dallojnë dhe janë më të ulëta, me qëllim për të lajthitur cmimin e saktë dhe prandaj radhitja e llogaritjeve është bërë në formë tjetër vetëm për të dalë në fund si OE më i lirë dhe jo sic ka kërkuar AK, ku dallimin e analizave financiare e gjeni më lartë për secilin pozicion.

Prandaj, Kompania SCORPION sh.p.k, në Analizën Financiare ka dhënë edhe një shpjegim shtesë për orët shtesë dhe ka përmbytur të gjitha kërkesat tuaja si AK duke respektuar radhitjen e saktë të llogaritjes së cmimit në analizën financiare të kërkuar nga ju si AK dhe dispozitat e ligjit të punës, ku kemi llogaritur pagën Net, orët e natës, festat zyrtar, pushimet vjetore, kontributet pensionale, fitimi i kompanisë, TVSH 18% dhe në fund totali për 36 muaj.

### Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin 3

Kerkesa e AK ishte që "Operatori ekonomik me ofertë duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë të pasqyruar më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimi e OE, TVSH-ne, Totali i ofertës".

Sipas nenit 41 të Rregullores së Prokurimiti pulik, 41.3 "Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbyshen të gjitha kushtet e mëposhtme :

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë". Ndërlidhur me këtë, asnjë oferte nuk përmbyshet këtë kusht.

kushti 1 - eshte permbushur kushti i pare sepse jane pranuar 8 oferta		Pranuar 8 oferta	
	Besa		169,672.32
	Delta		<b>160,963.20</b>
	Jaguar		167,356.80
	ISA		159,942.30
	Scorpion		151,770.24
	MEB		150,491.52
	Rojet		149,380.07
	Security		157,455.36
	total		<b>1,267,031.81</b>
	mesatarja		<b>158,378.98</b>
	30% i mesatares		<b>121,829.98</b>
kushti 2 - te gjitha ofertat nen kete cmim permbushin kushtin e dyte			
	10% ne mes dy ofertave		<b>145,402.09</b>
kushti 3 - oferta me e lire ne krahasim me oferten e dyte me te lire permbush kushtin e trete			
	pragu 10%		
Kushti	Kerkesa	Arsyetimi	
1	jane pranuar me shume se 3 oferta	është plotesuar kushti i pare sepse jane pranuar 8 oferta.	
2	çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të mbetur	Asnje oferte nuk përmbush kushtin e dytë	
3	çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Asnje oferte nuk përmbush kushtin e trete	

Asnje oferte nuk permbush kushtin e cmimit abnormal.

Pavaresisht nenit 41.3 te Rregullores se prokurimti publik, ofertat nuk permbushin kushtin e e cmimit abnormal as per pozicion. Shih kalkulimin:



kushti 1 - eshte permbushur kushti i pare sepse jane pranuar 8 oferta		Pranuar 8 oferta	prari 8-16 (5 dite)	prari 8-16 (7dite)	prari 16-24 (7dite)	prari 24-8 (7dite)
	Besa		2.47	2.47	2.64	2.98
	Delta		<b>2.25</b>	2.3	2.51	2.93
	Jaguar		2.65	2.61	2.61	2.61
	ISA		2.27	2.27	2.63	2.77
	Scorpion		2.39	2.35	2.35	2.41
	MEB		2.37	2.35	2.35	2.35
	Rojet		2.34	2.34	2.34	2.34
	Security		2.26	2.51	2.51	2.51
	total		<b>19.00</b>	<b>19.20</b>	<b>19.94</b>	<b>20.90</b>
	mesatarja		<b>2.38</b>	<b>2.40</b>	<b>2.49</b>	<b>2.61</b>
	30% i mesatares		<b>1.83</b>	<b>1.85</b>	<b>1.92</b>	<b>2.01</b>
kushti 2 - te gjitha ofertat nen kete						
	10% ne mes dy ofertave		<b>2.06</b>	<b>2.06</b>	<b>2.39</b>	<b>2.52</b>
kushti 3 - oferta me e lire ne		pragu 10%				
Kushti	Kerkesa	Arsyetime				
1	jane pranuar me shume se 3 oferta	otesuar kushti i pare sepse jane pranuar 8				
2	çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të mbetur	Asnje oferte nuk përmbush kushtin e dytë				
3	çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Asnje oferte nuk përmbush kushtin e tretë				

Gjithashtu, meqenese secili OE ka kalkuluar ne menyren e vet, ne menyre qe te gjitha ofertat te vleresohen ne menyre te barabarte, MSH ka kalkuluar minimumin e vleres se ofertave dmth ato te cilat mbulojne pagat e punetoreve sipas Ligjit te Punes. Menyra se si jane kalkuluar cmimet per ore nga ana e MSH eshte me se vijon:

Paga Bruto	288.11
Kontributi i punëtorit 5 %	14.41
Tatimi paga	8.7
Paga Neto	265.00
Kompanisë një punëtorë i kushton	
Paga Bruto	288.11
Kontributi i Kompanisë 5%	14.41
Gjithsej shpenzimi për pagën e një punëtori	302.52

5 dite				
#	TABELA E ÇMIMIT PER ORE KU PARASHIHEN TE GJITHA OBLIGIMET SIPAS LIGJIT TE PUNES			
ORARI I PUNES 08:00 - 16:00				
1		paga minimale bruto		
2	paga minimale EURO	288.11		
3				
4	kushtet sipas ligjit te punes	ore pune sipas kategorive	Çmimi per nje ore pune sipas kategorise	Çmimet
5	total ore pune sipas ligjit per nje muaj			
6	ore dite - cmimi normal	176	1.64	288.11
7	ore nate - 30%	0	0.49	-
8	ore festave - 50%	0	-	-
9	pushim vjetor min. 20 dite sipas ligjit	13.33	1.64	21.83
10	Kontributi pensional I kompanise (5% punedhenesi)			14.41
11	paga per nje punetor ne muaj			324.34
12	CMIMI TOTAL PER NJE ORE PUNE			1.84
13			TVSH	0.33
	TOTAL CMIMI PER NJE ORE PUNE ME TVSH			2.17

#	TABELA E ÇMIMIT PER ORE KU PARASHIHEN TE GJITHA OBLIGIMET SIPAS LIGJIT TE PUNES			
ORARI I PUNES 16:00 - 24:00				
1		paga minimale bruto		
2	paga minimale EURO	288.11		
3				
4	kushtet sipas ligjit te punes	ore pune sipas kategorive	Çmimi per nje ore pune sipas kategorise	Çmimet
5	total ore pune sipas ligjit per nje muaj			
6	ore dite - cmimi normal	176	1.64	288.11
7	ore nate - 30%	15.25	0.49	7.49
8	ore festave - 50%	7.33	0.82	6.00
9	pushim vjetor max. 20 dite sipas ligjit	13.33	1.64	21.83
10	Kontributi pensional I kompanise (5% punedhenesi)			14.41
11	paga per nje punetor ne muaj			337.83
12	CMIMI TOTAL PER NJE ORE PUNE			1.94
13			TVSH	0.35
	TOTAL CMIMI PER NJE ORE PUNE ME TVSH			2.29

#	TABELA E ÇMIMIT PER ORE KU PARASHIHEN TE GJITHA OBLIGIMET SIPAS LIGJIT TE PUNES			
ORARI I PUNES 00:00 - 08:00				
1		paga minimale bruto		paga minimale bruto
2	paga minimale EURO	288.11		
3				
4	kushtet sipas ligjit te punes	ore pune sipas kategorive	Çmimi per nje ore pune sipas kategorise	Çmimet
5	total ore pune sipas ligjit per nje muaj			
6	ore dite - cmimi normal	176	1.64	288.11
7	ore nate - 30%	45.75	0.49	22.47
8	ore festave - 50%	7.33	0.82	6.00
9	pushim vjetor max. 20 dite sipas ligjit	13.33	1.64	21.83
10	Kontributi pensional I kompanise (5% punedhenesi)			14.41
11	paga per nje punetor ne muaj			352.81
12	CMIMI TOTAL PER NJE ORE PUNE			2.03
13			TVSH	0.36
	TOTAL CMIMI PER NJE ORE PUNE ME TVSH			2.39

7 dite				
#	TABELA E ÇMIMIT PER ORE KU PARASHIHEN TE GJITHA OBLIGIMET SIPAS LIGJIT TE PUNES			
ORARI I PUNES 08:00 - 16:00				
1		paga minimale bruto		
2	paga minimale EURO	288.11		
3				
4	kushtet sipas ligjit te punes	ore pune sipas kategorive	Çmimi per nje ore pune sipas kategorise	Çmimet
5	total ore pune sipas ligjit per nje muaj			
6	ore dite - cmimi normal	176	1.64	288.11
7	ore nate - 30%	0	0.49	-
8	ore festave - 50%	7.33	0.82	6.00
9	pushim vjetor min. 20 dite sipas ligjit	13.33	1.64	21.83
10	Kontributi pensional I kompanise (5% punedhenesi)			14.41
11	paga per nje punetor ne muaj			330.34
12	CMIMI TOTAL PER NJE ORE PUNE			1.88
13			TVSH	0.34
	TOTAL CMIMI PER NJE ORE PUNE ME TVSH			2.21



Fjësia nr.	Përshkrimi i pozitës (a)	Niveli i pozitës (b)	Niveli i orëve (c)	Niveli total orëve për ditë (d) = (b) x (c)	Niveli total i orëve për muajt (e) = (d) x niveli i ditëve në muajt	Çmimi për orë pa TVSH (f)	TVSH (g)	Çmimi për orë me TVSH (h)	Çmimi mujor pa TVSH (i) = (g) x (f)	Çmimi mujor me TVSH (j) = (g) x (g)	Çmimi për 36 muajt (k) = (i) x 36
1	Sigurimi fizik - ne objektin e MSH-së	2	8 orë (88.00-16.00)	16	336	1.84	0.33	2.17	618.24	729.52	26,262.84
2	Sigurimi fizik - tek porta kryesore e objektit të MSH-së	1	8 orë (88.00-16.00)	8	240	1.88	0.34	2.22	451.20	532.42	19,166.98
3	Sigurimi fizik - tek porta kryesore e objektit të MSH-së	1	8 orë (16.00-24.00)	8	240	1.94	0.35	2.29	465.60	549.41	19,778.69
4	Sigurimi fizik - tek porta kryesore e objektit të MSH-së	1	8 orë (24.00-8.00)	8	240	2.03	0.37	2.40	487.20	574.90	20,696.26
5	Sigurimi fizik - ne Depon Qendrore të BARNAVE	1	8 orë (88.00-16.00)	8	240	1.88	0.34	2.22	451.20	532.42	19,166.98
6	Sigurimi fizik - ne Depon Qendrore të BARNAVE	1	8 orë (16.00-24.00)	8	240	1.94	0.35	2.29	465.60	549.41	19,778.69
7	Sigurimi fizik - ne Depon Qendrore të BARNAVE	1	8 orë (24.00-8.00)	8	240	2.03	0.37	2.40	487.20	574.90	20,696.26
<b>TOTALI (1-7)</b>											<b>145,546.68</b>

Sipas vlersimeve të MSH, të gjitha ofertat mbi 145,546.68 mbulojnë pagat minimale. Oferta e OE shpallur fitues ka vlerën totale mbi 145,546.68 dhe si e tillë plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara në Dosje të Tenderit. Prandaj pretendimi ankimor është i PA BAZUAR.

#### 4. Pretendimi ankimor 4

Poashtu, vendimi juaj bie ndesh edhe me Nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik ku thotë se, Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues.

Pra, Komisioni vlerësues i AK-së është dashur por nuk e ka shfrytëzuar kërkesën me shkrim për sqarimin e Analizës Financiare (duke u bazuar në sqarimet e dhëna më lartë të radhitja e llogaritjeve është e gabuar dhe jo sipas kriterëve në dosjen e tenderit, ku poashtu vlerat numerike për pozicionet 6,7,8 janë të paqarta se si janë llogaritur), por ka nxituar me nxjerrjen e vendimit me rast të rrjedhur edhe vendimi për shpalljen e fituesit, që bie ndesh me kërkesat dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues.

#### Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimin 4

Neni 59 (ekzaminimi i tenderëve) - sipas këtij neni AK mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Kjo vlen në rastet kur dicka nuk është e qarte në oferte. Perderisa OE ka dorëzuar Analizën financiare ku kjo analizë përfshinë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për ndërrimet e natës dhe festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimi e OE, TVSH-ne, AK nuk e ka pa të nevojë që të kërkojë sqarime shtesë nga OE. Gjithashtu, ju informojmë se AK nuk mund të refuzoj një ofertë për radhitje të llogaritjeve sepse AK nuk ka përcaktuar se si duhet të bëhet radhitja e llogaritjes. Prandaj pretendimi ankimor është i PA BAZUAR.

#### 5. Pretendimi ankimor 5

Duke u nisur nga të thënat si më lartë vijmë në përfundim se ju si AK keni rënë ndesh me Dispozitat e LPP-së, konkretisht me Nenin 60, kjo për arsye se ne si OE kemi përfillur të gjitha kriteret e dhëna në dosjen e tenderit, si dhe me nenin 60 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Prokurimin Publik, që parashihet kriteret e autoritetit kontraktues. Përkundër këtij legjislacioni, ju keni vepruar në atë



mënyrë duke na shpallur si të pasuksesshem në këtë procedure te prokurimit, te cilit i'u kemi përmbajtur në tërësi dhe me përgjegjshmëri të plotë.

Anadaj, duke u bazuar në të gjitha provat e bashkangjitura kërkojmë të aprovoni kërkesën tonë dhe lëndën të ktheni në Ri-Vlerësim dhe të bëni vlerësimin në mënyrë të drejtë dhe në harmoni me Ligjin e Prokurimit Nr. 04/L-042 , sepse në të kundertën do të detyrohemi të drejtohem edhe ne organet tjera kompetente.

#### **Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin 5**

Neni 60 “Kriteri për dhënie te kontratës”– sipas këtij neni AK do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; ose 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulet, pra ka respektuar nenin 60.1.1 pasi kriteri i shpërblimit ne Njoftimin për kontratë dhe ne DT ka qene tenderi i përgjegjshme me çmimin me te ulet. Prandaj pretendimi ankimor eshte i PA BAZUAR.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### **Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

#### **Vendimi i dorëzohet:**

1. Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion
2. Operatoreve ekonomik te interesuar.

  
**Berat Marmullaku**  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

